

VENDIM
Nr. 62, datë 29.1.2020

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJË SINË
ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE ÇAKTIMIN E FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” dhe “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, ish-Uzina Mekanike Bujqësore, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, zonë e re për zhvillim.
2. Çaktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për këtë zonë si njësi zbatuese, për:
 - a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
 - b) ndërtimin e rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe kritike;
 - c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
 - ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PIKA	Koord. X	Koord. Y
1	378228.72	4560333.78
2	378190.62	4560401.24
3	378271.59	4560370.29
4	378250.15	4560316.31
5	378261.27	4560236.94
6	378295.40	4560154.39
7	378237.45	4560128.19
8	378243.80	4560108.35
9	378117.60	4560055.96
10	378074.74	4560153.59
11	378208.88	4560209.95
12	378168.40	4560310.76
13	378228.72	4560333.78
14	378150.94	4560199.63
15	378082.67	4560169.47
16	378123.15	4560271.86
17	378123.15	4560284.56
18	378156.49	4560298.06
19	378166.81	4560273.45
20	378131.09	4560256.78
21	378150.94	4560199.63

